



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Hartim Projektsh për rrugët në territorin e Bashkisë Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
22114311-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,984,786.37 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 99,695 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 9 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 30% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar.....”;*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2025 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).*

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (shërbimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për shërbime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 19 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg, bazuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

Kat. 6 a) – Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

Kat. 7 a) –Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Kat. 8 a) – Rilevime inxhinierike.

Kat. 8 e) – Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Kat. 11 a) – Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytesore, rrugë interurbane dytesore, sheshe e parkime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kat. 6 a) – Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, ku investimi lidhet me infrastrukture rrugore, që kërkon hartimin e planimetrise së rruges, profileve terthore, llogaritjen e shtresave , preventivin etj

Kat. 7 a) –Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, gjatë realizimit të projektit të rruges është përmendur që ka nevojë edhe për detaje dhe llogaritje perkatese për veprat e artit, kryesisht mure, tombino, ure ose box b/a etj.

Kat. 8 a) – Rilevime inxhinierike.

Kat. 8 e) – Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet të kryhet azhurnimi i rrugëve dhe azhurnimin e rrjetit të infrastruktures, të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha etj, të jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

Parashikohet identifikimi dhe shënimi i pikave për pozicionim dhe rilevim, hartimi i përshkrimeve për pikat e palëvizshme dhe shoqëruar me skemat përkatëse, kryerja e matjeve për të përcaktuar pikat fikse dhe ato të kontrollit, si dhe analizimi i matjeve dhe hartimi i rrjetit mbështetës gjeodezik dhe atë të rilevimit, rrjedhimisht gjykohet e nevojshme kjo pikë për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

Kat. 11 a) – Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, ku investimi lidhet me infrastrukture rrugore, tek e cila parashikohet që të kryhen edhe sinjalistika perkatese, të vendosen tabela rrugore etj.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi, Profili Infrastrukture Transporti/Rruge Ura

1 (nje) Inxhinier Elektrik;

1 (nje) Inxhinier Gjeodet/topograf/markshajder

Për punonjësit, drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesë, Kontratë pune të vlefshme, Diplomë, Licensë profesionale për projektim, si dhe të figurojnë në listëpagesa për të paktën periudhën muajn e fundit të deklaruar (Korrik 2025).

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për stafin si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Infrastrukture Transporti/Rruge Ura - Gjykohet si e nevojshme prezenca e 1 (një) Inxhinier Ndertimi për hartimin e projektit teknik të rruges, preventivin, llogaritjet analitike. I nevojshëm sipas kategorive të licences, cituar në detyrë të projektimit, konkretisht për kategoritë (6.a, 7.a, 11.a).

1 (nje) Inxhinier Elektrik - Gjykohet si e nevojshme prezenca e 1 (nje) Inxhinieri Elektrik per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me hartimin e projektit per ndricimin rrugor aty ku është e domosdoshme.

1 (një) Inxhinier Gjeodet/topograf/markshajder - Gjykohet si e nevojshme prezenca e 1 (një) Inxhinier Gjeodet për kryerjen e rilevimit topografik dhe perpunimin matjeve në sisteme koordinative të ndryshme dhe përgatitjen e vizatimeve përkatëse për matjet e realizuara. I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite (6.a, 8.a, 8.e).

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë **staf mbështetës**, si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi, Profili Infrastrukture Transport/Rruga-Ura etj.

1 (nje) Inxhinier Gjeodet/topograf/markshajder

Për stafin mbështetës, OE duhet të paraqese, Kontratë pune të vlefshme, Çertifikate/Diplomë, Licensë profesionale për projektim, si dhe te figurojnë në listëpagesa për të paktën periudhën muajn e fundit të deklaruar (Korrik 2025).

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për stafin si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier ndertimi profili infrastrukture/transport/rruga-ura etj

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me projektimin e shtresave rrugore sipas gjurmes ku do te kalojë rruga, duke percaktuar llojin e materialit qe do te perdoret dhe trashesine e tij per çakull, stabilizant, asfalt, etj , per sinjalistiken rrugore, per caktimin e tipeve te rruges etj. I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 11 a),

1 (nje) Inxhinier Gjeodet/topograf/markshajder

Kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me azhurnimin e rruges dhe te gjithë hapesires ku mendohet te kaloje sistemi i ujerave te bardha, te jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak ne terren per sakesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimi, si dhe hartimin e planeve profileve terthorë dhe gjatësore topografike me kuota relative dhe absolute. Gjithashtu nevojitet edhe per matjet topografike ne terren me pajisje te ndryshme topogjeodezike.

I nevojshem sipas kategorive te licences, cituar ne detyre te projektimit, konkretisht per kategorite 8 a), dhe 8 e).

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **5 (pesë) persona**, vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen muajin e fundit të deklaruar (Korrik 2025).
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, per periudhen muajin e fundit të deklaruar (Korrik 2025).

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore te te nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhen muajin e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindese per AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marre ne konsiderate se rendesine e ktij sherbimi per AK.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit, e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certificate te vlefshme:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente, e vlefshme, te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë ose European Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për

prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatori ekonomik të jete i certifikuar për cilesinë. të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- **1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;**
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë/kontratë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit original ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.
- **1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.**
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë/kontratë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit original ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.
- **1(një) Pajisje dron për fotogrametri dhe matjet**
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë/kontratë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit original ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Këto pajisje, kerkohen për të kryer matjet topografike dhe rilevimet që lidhen me percaktimin e gjurmës dhe kuotave topografike për objektin, vecanërisht për zonat ku ka dendësi bimë ose ndërtesash dhe pajisja gjeodezike GPS nuk funksionon mirë me valet në këtë zonë, nevojitet pajisja Total Station Ose Pajisje droni.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në

planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Ne rast se oferta është me e ulët se minimumi ose më e lartë se maksimumi i përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor ajo do të skualifikohet.

Argumentim: Është vendosur kjo kërkesë bazuar në njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.....etj. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.....”, sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jete kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.3863 Prot, datë 21.08.2025 “Dërgim dokumentacioni” sipas detyrës së projektimit bashkëlidhur.

Afatet e ekzekutimit: Brenda 45 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

- | | |
|------------------|------------------------------|
| 1. Pjeter Bushi | Kryetar (Përsoni përgjegjës) |
| 2. Altin Marashi | Anëtar |
| 3. Rudolf Toma | Anëtar |